



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORCË

VENDIM

Nr. 40 ,Datë 06/05/2010

PËR

**NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MATERIALEVE TË  
INVENTARIT EKONOMIK DHE ATIJ TË IMËT**

Këshilli i Bashkisë së Qytetit Korçë, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e pergatitur nga Komisioni i Inventarizimit dhe Drejtoria e Financës për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit ekonomik dhe atij të imët, në zbatim të Ligjit nr.8652,datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32 pika “e”, Ligjin nr.6492, datë 25.12.1984 “Per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave meteriale dhe monetare”, të ndryshuar me Ligjin nr. 7426,datë 14.11.1990, V.K.M nr.70,datë 11.03.1985 ” Për administrimin,ruajtjen,dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave meteriale dhe monetare”,të ndryshuar me V.K.M Nr.170, date 03.04.1993, si dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve ,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve sipas llogaritjeve të mëposhtme:
  - a. Inventar ekonomik 2.609.169 (dy milion e gjashtëqind e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjete e nente) lekë.
  - b. Inventar i imët 215.700,8 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind pikë tetë) lekë.
2. Materialet të cilat do të nxirren jashtë përdorimit janë të pasqyruara në procesverbalet bashkangjitur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetese.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**GJERGJI PENDAVINJI**